



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.04.2025
REFERENC-Ë:	5360/24 - ZSP 2025 ; ARPL
PËR/ZA/TO:	Gazmend JAKUPI, Ruboc, Komuna e Kamenices
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pelqim Ujor ,

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. të protok. 5360/24, nga pala, Z. Gazmend JAKUPI, K. Kamenicë, për kalim mbi pronë ujore, dhe ka vendosur si në Vendim, Pëlqim Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë: 23.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PELQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palëve: Z Gazemend JAKUPI, me nr. Protok. 5360/24, për kalim me urë, mbi pronë ujore, me **P- 71107066-00952-2**, në K. Kamenicë;

Nën Kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet për kalim të lirë me urë mbi pronën ujore, nr. P- 71107066-00952-2, P.Sh. Ujërat, në koordinata (X=7547141.665;Y=4 715 157), nga prona private e palës, me nr.ngastres P-71107066-00603-5, Zona Kadastrale Ruboc, K. Kamenicë, në baze të dokumentacionit investivo-teknik i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe si i tillë ruhet nga pala;
2. Kalimi mbi pronën ujore, bëhet vetëm për pjesën, respektivisht në gjërësi prej 5.0 m' në vendin e paraparë si në situacion;

3. Pala duhet të ketë parasysh se, kalimi i lire nuk do të thotë se prona mund të kaloj në pronësi të palës, si dhe perveq kalimit nuk duhet të ketë destinim tjetër, pra duhet të ruaj funksionalitetin aktual, duke mos ndërtuar infrastruktur, përveq se asaj të kalimit etj;
4. Në pjesën tjetër të pronës ujore, nuk lejohet ndërtim, apo çfarëdo llojë aktiviteti tjetër të paraparë, që nënkupton shfrytëzim;
5. Pëlqimi vlen vetëm për kalim mbi pronën ujore, ndërsa për kycje në rrugën publike, duhet të siguroj pëlqim nga organi kompetent për Infrastruktura rrugore.
6. Pala duhet të ketë parasysh, se me rastin e hartimin e Planit të Menagjimit të Resurseve ujore, nëse do të vendoset për kushte tjera, ndryshe nga rasti, duhet të adaptohet atyre, sipas kërkesave të nevojshme, pa ndonjë kompensim;
7. Pëlqimi ujqor ka afatin kohorë prej 2 viteve, nese deri atëherë nuk e ka filluar ndërtimin.

Arsyetim

Pala, Z. Gazmend JAKUPI, ka bërë kërkesë, me nr. prot. 5360/24, lidhur me mundësin e kalimit mbi Pronën Ujqore. pala kërkesës i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijom: Elaborati i hidrogeologjise së Lumit të Rubovcit ("Geo – DS" Sh.p.k. ; Dipl e Diamant Refik Latifaj si gjeodet i licencuar , me nr.193 të licences;marreveshja ne mes te pales per bashpunim; Diploma e Z. Refik Bajram Latifi, noterizuar; diplomë e inxhinierit të ndërtimtarisë , Z Shaban Selim Kastrati; Diplomë e Z. Mexhid Mustafë Zylfiu, inxhinier i diplomuar i ndertimit , drejtimi hidroteknik; leter informate nga Drejtoria për Urbanizem dhe Planifikim Hapësinor, sektori për Leje Ujqore; Certifikate e pronësisë, Parcela, me nr P-71107066-00602-0, në pronsë të palës , z. Gazmend JAKUPI; kopje e planit per parcelen , me nr. P-71107066-00602-0; Deklata nen Betim, LRP. Nr 7681/2024;Kërkesë për komunen për kushte ujore; Certifikata e pronësisë, me nr P-71107066-00593-1 në emer të Hysen Jakupi; Andaj pas shqyrtimit të kërkesës , dokumentacionit tekniko investivo teknik, është vendosur si në dispozitiv. Bazuar në pronocimin e drejtorit, duke u bazuar në takimet që kemi pasur dhe informatat faktike që ju kan ofruar nga unë si zyrtare përgjegjëse, si dhe sqarimin që ka bërë udhëheqësja e DMRU-së, lëndët janë procesuar për nënshkrim, të cilat ishin kthyer, me 01.04.2025 nga ZSP-ja.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 5360/24 - ZSP- 2025 Datë: 23.04.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Kamenicë;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI